



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor, e mbajtur me datën 04.12.2025, në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin: Valon Prebreza - Kryetar i zgjedhur.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Hajredin Mjeku, Vlonjat Hasani, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Hasime Kostanica, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Mirlinda Krasniqi, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Ali Topalli, Etnik Berjani, Rineta Bërbatovci, Vjosa Kida Hyseni, Rrahim Tërnavë, Valon Murseli, Ermal Dumani, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Bashkim Krasniqi, Gëzim Gara, Ali Ismaili, Driton Ademi, Vildane Latifi dhe Radoman Dedorevic.

Të tjerë: Musafirë të ftuar, përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe Media.

Kryesuesi i Mbledhjes Inauguruese z. Hajredin Mjeku: Mbështetur në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mbledhjen inauguruese e hapi dhe e kryesoi anëtarë më i vjetër i Kuvendit të Komunës z. Hajredin Mjeku. Të nderuar/a përfaqësues të institucioneve komunale, të nderuar/a koleg/ë asambleist/e, përfaqësues të subjekteve politike, përfaqësues të mediave dhe të pranishëm të nderuar/a, është nderë i veçantë për mua që si anëtarë më i moshuar i kësaj Asambleje të re, të kem privilegjin ta hap këtë mbledhje inauguruese të Asamblesë Komunale të Fushë Kosovës. Ky moment shënon fillimin e një mandati të ri, me përgjegjësi të reja dhe me pritje të mëdha nga qytetarët tanë. Ata na kanë dhënë besimin për t'i përfaqësuar me ndershmëri, përkushtim dhe punë të drejtë. Ky besim është një detyrim i madh moral e qytetarë, që secili prej nesh duhet ta mbajë me përgjegjësi. Pavarësisht bindjeve tona politike, të gjithë kemi një qëllim të përbashkët: zhvillimin e Komunës sonë, përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe forcimin e institucioneve lokale. Le ta nisim këtë mandat me mirëkuptim, respekt të ndërsjellë dhe bashkëpunim, sepse vetëm të bashkuar mund të arrijmë rezultate të prekshme për qytetarët e Fushë-Kosovës. Me këto fjalë e shpall të hapur mbledhjen inauguruese të Asamblesë Komunale të Fushë-Kosovës.

Ju faleminderit dhe punë të mbarë të gjithëve.

Tani kalojmë në aspektin procedural të verifikimit formal të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2025-2029, ku mbështetur në nenin 35, paragrafi 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, e formojmë një Komision për verifikimin e mandateve prej tre anëtarëve: në vazhdim nga subjektet politike për anëtar/e të Komisionit u propozuan znj. Arlinda Mekolli, Jetmir Berisha dhe Ermal Dumani, ky komision u votua njëzëri dhe u tërhoq jashtë sallës së Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e dokumentacionit zgjedhor të lëshuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

Arlinda Mekolli: Përsëritet të gjithë të pranishmit në mbledhje. Komisioni për verifikimin e mandateve, i caktuar nga Kuvendi i Komunës, verifikoi listën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndryshimet e realizuara me dy vendime tjera të Komisionit Qendror Zgjedhor për mandatin

zgjedhur 2025-2029 dhe konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore dhe formale, për realizimin e procedurës së betimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e përbërë prej tridhjetë e një anëtarëve.

Kryesuesi i mbledhjes - Hajredin Mjeku: Falënderoi Komisionin për punën e realizuar, lexoi deklaratën e betimit më zë dhe ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, për ta lexuar dhe nënshkruar Deklaratën e Betimit, konform konstatimit të dhënë nga Komisioni për verifikimin e mandateve:

Anëtari/ja që dhanë betimin dhe nënshkruan deklaratën janë si vijon:

1. Hajredin Mjeku - Kryesues i mbledhjes, anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje;
2. Vlonjat Hasani - anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje;
3. Festim Pllana - anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje;
4. Hasime Kostanica - anëtare nga Lëvizja Vetëvendosje;
5. Daut Krasniqi - anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje;
6. Kushtrim Mirena - anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje;
7. Kosovar Ademi - anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje;
8. Rrahim Sogojeva - anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje;
9. Filloreta Musaj - anëtare nga Lëvizja Vetëvendosje;
10. Arlinda Mekolli - anëtare nga Lëvizja Vetëvendosje;
11. [Mirlinda Krasniqi - anëtare nga Lidhja Demokratike e Kosovës;](#)
12. Afrim Dumani - anëtar nga Lidhja Demokratike e Kosovës;
13. Laureat Gojnovci - anëtar nga Lidhja Demokratike e Kosovës;
14. Jetmir Berisha - anëtar nga Lidhja Demokratike e Kosovës;
15. Burim Berisha - anëtar nga Lidhja Demokratike e Kosovës;
16. Ali Topalli - anëtar nga Lidhja Demokratike e Kosovës;
17. Etnik Berjani - anëtar nga Lidhja Demokratike e Kosovës;
18. Rineta Bërbatovci - anëtare nga Lidhja Demokratike e Kosovës;
19. Vjosa Kida Hyseni - anëtare nga Lidhja Demokratike e Kosovës;
20. Rrahim Tërnavë - anëtar nga Partia Demokratike e Kosovës;
21. Valon Murseli - anëtar nga Partia Demokratike e Kosovës;
22. Ermal Dumani - anëtar nga Partia Demokratike e Kosovës;
23. Aida Alimi - anëtare nga Partia Demokratike e Kosovës;
24. Dardane Sogojeva Shala - anëtare nga Partia Demokratike e Kosovës;
25. Migjen Kolshi - anëtar nga Partia Demokratike e Kosovës;
26. Bashkim Krasniqi - anëtar nga Partia Liberale Egjiptiane;
27. Gëzim Gara - anëtar nga Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës;
28. Ali Ismaili - anëtar nga Zëri i Drejtësisë;
29. [Driton Ademi - anëtar nga Nisma Socialdemokrate;](#)
30. Vildane Latifi - anëtare nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe
31. Radoman Doderovic - anëtarë nga Lista Serbe.

Kryesuesi i mbledhjes - Hajredin Mjeku: Ftoi Kryetarin e zgjedhur të Komunës z. valon Prebreza që ta lexon dhe nënshkruan Deklaratën e Betimit.

Kryetari i Komunës z.Valon Prebreza, lexoi dhe nënshkroi Deklaratën e Betimit.

Kryesuesi i mbledhjes z. Hajredin Mjeku: Ftoj Kryetarin e Komunës që ta mbaj një fjalë rasti.

Valon Prebreza - Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës: Të dashur asambleistë të ri të Asamblesë Komunale të Fushë-Kosovës, të nderuar/a përfaqësues të institucioneve komunale, Bashkësisë Islame të Kosovës, Policisë, të Organizatave të dala nga lufta, Shoqata të pensionerëve, mysafirë të dashur, mirë se keni ardhur dhe mirë se e gjejmë njëri-tjetrin këtu. Dua të ju falënderoj të gjithëve, edhe ju që na ndihmuat për tu bërë ky ndryshim i madh në Fushë-Kosovë, edhe ju që nuk e përkrahët, mirëpo e pranuat këtë ndryshim. Faleminderit dhe punë të mbarë, të përbashkëtë, na shkoftë gjatë këtyre katër viteve. Fushë-Kosova në zgjedhjet e fundit vendosi për të ndryshuar, qeverisjen, kur thuhet kështu duket, sikur nuk ka ndodhur ndonjë gjë e madhe, mirëpo të kemi parasysh se këtu kemi pasur një qeverisje mbi njëzet 20 vite, atëherë ky ndryshim nuk është një ndryshim i thjeshtë, por është një ndryshim rrënjësor, një ndryshim i domosdoshëm me të vetmin qëllim, që ky ndryshim do të jetë për të mirën e qytetarëve të përbashkëtë, për të mirën e qytetarëve të përgjithshme. Kjo besoi se është pika, ku pajtohemi të gjithë, sepse të gjithë kemi marrë votën për të bërë këtë ndryshim në Fushë-Kosovë dhe për t'i shërbyer qytetarëve të Fushë-Kosovës. Nga sot ju ftoj të gjithëve pa marrë parasysh, se prej cilit subjekt politik vini, pa marrë parasysh identitetin kombëtar, që bashkërisht gjatë këtyre katër vjetëve, ta shtrijmë dorën e bashkëpunimit në mënyrë, që të punojmë për të mirën e qytetarëve të Fushë-Kosovës, pa dallim, pa hezitim dhe me një vullnet të plotë, bashkarishtë derën e hapur do ta keni të gjithë në mënyrë, që projektet në të mirën e qytetarëve të Fushë-Kosovës, t'i dërgojmë përpara dhe ta lehtësojmë jetën për ta. Natyrisht unë jam i vetëdijshëm për sfidat e mëdha që kemi përpara, për ta realizuar këtë sidomos është e vështirë të realizohet, kur kemi parasysh se njëzet 20 vite është punuar, mirëpo nuk janë përmbushur nevojat dhe kërkesat e duhura, secili ka jetën e vet, pasionet dhe problemet e veta, mirëpo të gjithë e kanë të përbashkëta rrugën publike, mjedisin ku jetojnë, shkollën, kulturën e sportin, strehimin dhe sigurinë, pra secili qytet e vendbanim ka dy sfera - sferën private dhe sferën publike, pra sferën e veçantë ku qytetarët bëjnë punën dhe jetën e vetë dhe sferën e përbashkëta, ku interesat e tyre bashkohen, takohen, gërshetohen e ndonjëherë edhe konfliktohen. Të dashur koleg/ë, komuna duhet të ju shërben të gjithëve njëjtë, por duhet të jetë edhe rregullator mes të veçantës dhe të përgjithshmes, nuk mundet komuna të zhvillojë të përgjithshmen, pa çarë fare kokën për të veçantën, por as të veçantën nuk mund ta vendosë mbi të përgjithshmen, pra duhet të jetë një lloj rregullatori që të balancojë zhvillimin, mes atyre që kanë më shumë ide dhe vullnet që me bizneset e tyre të kontribuojnë në zhvillimin dhe atyre që kanë më pak, por që duan të kenë të sigurt hapësirën e tyre publike dhe jetën e tyre publike. Për mos ta zgjatur shumë, unë llogarisë në ndihmën e secilit prej juve për të arritur këtë, sepse nuk jam duke kërkuar asgjë të jashtëzakonshme, thjeshtë po kërkoj një komunë që ju shërben të gjithëve, duke llogaritur në ndihmën tuaj për këtë unë ju falënderojë gjithë secilit dhe ju ftoj, që të bashkëpunojmë në katër vitet e ardhshme sinqerisht dhe haptazi. Kërkoj falje për mos falënderimin e ish Kryetarëve të deritanishëm, duke përfshirë nga Kryetari i parë prej Komunës së Fushë-Kosovës, z. Naser Grajçevci, kryetarin e dytë z. Skënder Zogaj, si dhe Kryetarin e deritanishëm z. Burim Berisha, faleminderit për punën që keni bërë deri tani. Të nderuar të pranishëm në katër vitet e ardhshme do të jem Kryetar, që do të vijë këtu ne sallë për tu ballafaquar me idetë dhe problemet, që i kemi

dhe për të zhvilluar projekte të përbashkëta. Faleminderit për pjesëmarrje, për mysafirë unë do të dal jashtë që t'i pres, do të vazhdojmë për pjesën tjetër me pika tjera. Faleminderit.

Kryesuesi i mbledhjes z. Hajredin Mjeku: theksoi se tani me dakordimin dhe pajtimin e juaj shkojmë në një pushim prej 20 minutave dhe vazhdojmë me pikën e radhës.

Pas kohës së pushimit mbledhja vazhdoi me pikën për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, edhe këtu sipas dispozitave ligjore duhet ta formojmë në Komision prej pesë anëtarëve, sqaroi se procedura e votimit është e fshehtë, varësisht prej numrit të kandidatëve për këtë pozitë për udhëheqjen e Kuvendit të Komunës, andaj tani ju ftoi subjektet politike që të japin propozimet e tyre për anëtarë të 'Komisionit për zhvillimin e procedurës së zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës'.

Për anëtarë të Komisionit u propozuan: Arlinda Mekolli, Afrim Dumani, Aida Alimi, Bashkim Krasniqi dhe Vildane Latifi, komisioni në fjalë u votua njëzëri dhe filloi zhvillimin e procedurës për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Ftoi subjektet politike që të paraqesin propozimin e tyre për Kryesues të Kuvendit të Komunës.

Arlinda Mekolli: Edhe njëherë përshëndetje për të gjithë koleg/e, anëtar/e dhe mysafirë të nderuar/a, ju faleminderit për mundësinë që para jush në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, të paraqesë kandidaturën për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, emri ynë i propozuar është z. Vlonjat Hasani, i lindur më 30.06.1988 në Prishtinë, hapat e parë të arsimimit i nisi në shkollën fillore 'Vëllezërit Frashëri' në Miradi të Epërme, shkollën e mesme ekonomiko-juridike 'Hoxhë Kadri Prishtina' në Prishtinë, studiues i Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Filozofik në Shkenca Politike pranë Universitetit Publik të Prishtinës. Me trashëgimi të çmuar familjare, me arsimim e kulturë dhe me profesionin e politologut, Vlonjati ka një rrugëtim mbi vlerat, përkushtimin dhe ndershmërinë. Zëri i qytetarëve të Fushë-Kosovës, si asambleistë nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës - Vlonjati ka përfaqësuar aktivisht qytetarët për tema të rëndësishme nga arsimi, kultura, rinia e sporti deri tek ambienti, infrastruktura dhe nevojat sociale ekonomike, ai vazhdon me të njëjtin motivim, energji dhe vizion për të qenë përsëri zëri i fuqishëm i qytetarëve, në çdo sallë vendim marrje, i angazhuar në dhjetëra nisma e iniciativa për komunitetin Vlonjati, ka treguar se politika për të është mision për të arritur përmbushjen e nevojave të komunitetit. Vlonjati ka qenë aty ku kërkohet, veprim çoftë për të mbrojtur ambientin, për të përmirësuar kushtet e jetesës apo për të hapur horizonte të reja për të rininë. Sot kam kënaqësinë dhe nderin që z. Vlonjat Hasani me shumë meritë ta propozojmë para këtij Kuvendi si të mandatar për Kryesues të Kuvendit të Komunës të Fushë-Kosovës, ju ftoj të gjithëve, ta votojmë e ta mbështesim në detyrën e re. Faleminderit shumë.

Komisioni shqyrtoi shkurt zhvillimin e procedurës dhe ndarjen e detyrave të punës, ftoi për votim të fshehtë një nga një anëtarët e Kuvendit të Komunës si vijon:

1. Afrim Dumani
2. Aida Alimi
3. Ali Topalli
4. Ali Ismaili
5. Arlinda Mekolli
6. Bashkim Krasniqi
7. Burim Berisha

8. Daut Krasniqi
9. Dardane Sogojeva Shala
10. Driton Ademi
11. Ermal Dumani
12. Etnik Berjani
13. Festim Pllana
14. Filloreta Musaj
15. Gëzim Gara
16. Hasime Kostanica
17. Hajredin Mjeku
18. Jetmir Berisha
19. Laureat Gojnovci
20. Kushtrim Mirena
21. Kosovar Ademi
22. Migjen Kolshi
23. Mirlinda Krasniqi
24. Rineta Bërbatovci
25. Radoman Doderovic
26. Rrahim Tërri
27. Rrahim Sogojeva
28. Valon Murseli
29. Vildane Latifi
30. Vjosa Kida Hyseni
31. Vlonjat Hasani

Pas zhvillimit të procedurës së fshehtë të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, thirrjes një nga një të anëtarëve të Kuvendit të Komunës: votuan gjithsej 20 anëtarë të Kuvendit të Komunës 'për' dhe njëbëdhjetë anëtarë të Kuvendit të Komunës, abstenuan nuk morën pjesë në votim fare.

Arlinda Mekolli: Pas numërimit publik të votave, foli në emër të Komisionit për zhvillimin e procedurës së votimit, theksoi se z. Vlonjat Hasani u zgjodh Kryesues i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës me gjithsej 20 vota 'për' të anëtarë të Kuvendit të Komunës 'për' dhe njëbëdhjetë anëtarë të tjera të Kuvendit të Komunës, që abstenuan duke mos marrë pjesë fare në procedurën e votimit.

Kryesuesi i mbledhjes Hajredin Mjeku: Pas raportit të Komisionit konstatoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim - gjithsej njëzet Kryesues i Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2025-2029 u zgjodh z. Vlonjat Hasani dhe mori:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e Propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për zgjedhjen e z. Vlonjat Hasani i lindur me datën 30.06.1988, me vendbanim në fshatin Miradi e Epërme - Bachelor i Shkencave Politike - Politolog, në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2025-2029.

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, i zgjedhuri do të filloj t'i ushtroj nga data 04.12.2025, sipas dispozitave ligjore e statutore dhe për punën e tij, i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
3. Punët dhe detyrat e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, janë të parapara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjigjesitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe Rregulloren për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013.
4. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit, sipas Ligjit 08/L-196 për Pagave në Sektorin Publik, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi i mbledhjes Hajredin Mjeku: Ftoi Kryesuesin e zgjedhur të Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2025-2029 u zgjodh z. Vlonjat Hasani që ta marrë fjalën dhe pozitën e re.

Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës: Përsëritet për të gjithë të pranishmit, shumë i nderuar Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës z. Valon Prebreza, të nderuar/e koleg/e të Kuvendit të Komunës të Fushë-Kosovës, ju uroj të gjithëve mandatin e ri, duke dëshiruar që gjithçka të shkojë mirë dhe mbarë në rrugëtimin tonë të përbashkët, kam menduar që s'do të kem emocione të tillë, tash po i kuptoj ish Kryesuesit e kaluar, kështu që po vazhdojmë me të pranishmit e tjerë përfaqësues të organizatave të dalura nga lufta, përfaqësues të Forcës së Sigurisë të Kosovës, Policisë, përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës, përfaqësues të shoqërisë civile, media, familjar, zonja dhe zotërinj qeveritë ekzistojnë për të bërë punë, që njerëzit nuk mund t'i bëjnë vetë e kjo qeverisje mungoi për gjatë në Komunën e Fushë-Kosovës, e unë bashkë me Grupin Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në mandatin e kaluar por edhe në pozitën tjetër mandatin e kaluar ishim kritikë, ndaj asaj qeverisje që shkoi dhe nuk i qëndroi pranë qytetarit, mandej unë u akuzova shpesh për kritikën e vazhdueshme. Nga sot po ndryshojnë gjërat në Fushë-Kosovë, kemi një ekzekutiv të ri që do t'i ndihmojë njerëzit, por ajo që nuk ka ndryshuar është qasja ime ndaj kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, të cilat do të jenë përgjatë këtij mandati. Do të jem kujdestar i ekzekutivit, bashkë me ju me pozitën dhe opozitën, do të jem kritik i punëve të ekzekutivit, nëse është nevoja, por duke u bazuar në kryetarin e ri dhe ekipin e tij, besoi që kjo nuk do të ndodh asnjëherë, do të jem lavdëruar i punëve të mira dhe besoi, që kjo do të më bie ta përsërisë shumë shpesh, e sigurisht që do t'i përkrah kritikën e opozitës që kanë vend e shpresoi, që nuk kanë vend asnjëherë. Të nderuar asambleistë, votues dhe jo votues, të dashur qytetarë të Fushë-Kosovës, sot qëndroi këtu para jush me ndjesinë e përgjegjësisë dhe nderin, sot me votën tuaj më është besuar detyra e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, një rol që nuk është privilegj personal, por një amanet publik. Ky moment mi kujton fjalët e disa politologëve botëror 'Pushteti ka vlerë vetëm kur përdoret për të mirën e njerëzve', ky moment që tani po hyjmë, është një periudhë, ku transparenca nuk është opsion, por është domosdoshmëri. Qytetarët meritojnë ta dinë se si menaxhohen financat, se si merren vendimet, kush mban përgjegjësi për ato vendime dhe si Kryesues i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, do të angazhohem për procese të hapura, mbledhje të qasshme dhe komunikim të rregullt me qytetarët. Institucionet që nuk komunikojnë nuk mund të ndërtojnë ura të besimit, andaj ne do të tentojmë, që të rikthejmë dhe të forcojmë këtë besim të munguar për njëzet e pesë 25 vite. Kuvendi ynë duhet të jetë shembull i kulturës

demokratike, debat konstruktiv dhe jo konflikt personal, kritik me argumente dhe jo me emocione, bashkëpunim për të ardhmen dhe jo ndarje për interesa të vogla, do të punojmë fuqishëm që kjo sallë të bëhet vend dialogu dhe jo vend i përçarjes, ta bëjmë këtë për hirë të Zotit fillimisht, pastaj për hirë të qytetarëve, dëshmorëve, familjeve të tyre, invalidëve të luftës, kontribuesve të ndryshëm të fushave të ndryshme si dhe aktivistëve dhe aktivisteve që bëjnë punë të hajrit për shoqërinë. Zhvillimi i Fushë-Kosovës është qëllimi ynë i përbashkëta. Qyteti ynë meriton projekte që prekin jetën e përditshme të njerëzve, infrastrukturën më të mirë, ambient më të pastër, investime në arsim, në rini, kulturë, sport, mbështetje për bizneset lokale dhe një administratë që respekton çdo qytetarë njësoj. Të gjitha këto u lanë anash për një kohë të gjatë dhe secila prej tyre thërret me urgjencë, andaj na presin punë dhe angazhime të mëdha, së fundi dua ta them edhe këtë, të jetë ky mandati ku Fushë-Kosova ecën përpara me unitet, me integritet, me guxim dhe me zhvillim për qytetarët tanë. Zoti na ndihmoftë në rrugëtimin tonë të përbashkëta. Faleminderit.

Valon Prebreza - Kryetari i Komunës: Ftoi të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike pa asnjë dallim, që bashkarisht në orën 12:00h, të marrin pjesë në vizitën e përbashkëta në varreza dhe vendosjen e kurorave me lule në Shtatorën e Komandantit Legjendar Adem Jashari në Fushë-Kosovë dhe në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në orën 11:20 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Mbledhjes
Hajredin Mjeku

